

FONDACIONI KOSOVAR PËR SHOQËRI CIVILE
Prishtinë / Kosovë

Pasqyrat financiare dhe raporti i auditorit të pavarur
Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2018

Përbajtja

	Faqe
Raporti i Auditorit të Pavarur	3
Pasqyra e pozitës financiare	5
Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse	6
Pasqyra e aktiviteteve dhe ndryshimeve në pasurinë neto	7
Pasqyra e rrjedhjes së parasë	8
Shënimet e pasqyrave financiare	9-19

Shkurtësat

KCSF	Kosovar Civil Society Foundation
UNMIK	The United Nations Mission in Kosovo
OSI	Open Society Foundation London
BTD	Balkan Trust for Democracy
CSFG	Civil Society Grant Fund
DSP	Democratic Society Promotion
EUOK	The European Union Office in Kosovo
KFOS	Kosovo Foundation for Open Society
NOR	Royal Norwegian Embassy in Kosovo
SIDA	Swedish International Development Cooperation
OSFF TTF	Open Society Foundations Think Tank Fund
TACSO	Technical Assistance to Civil Society Organizations
DANIDA	Danish International Development Agency

Raporti i Auditorit të Pavarurinfo@bakertillykosovo.com
www.bakertillykosovo.com

Për menaxhmentin e Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile

Opinioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (Organizat), të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit finanziar me 31 dhjetor 2018 dhe pasqyra e të ardhurave, pasqyra e ndryshimeve në fonde dhe pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin që përfundoi në atë datë, dhe shënimet e pasqyrave financiare, përfshirë politikat domethënëse të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2018 janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kërkesat për raportim financiar të organizatës dhe ligjeve relevante në Kosovë.

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tutje në seksionin *Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare* e këtij raporti.

Ne jemi të pavarur nga organizata në pajtueshmëri me kërkesat etike që janë relevante gjatë auditimit tonë të pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbrushur përgjegjësitë tona etike në pajtueshmëri me këto kërkesa. Ne besojmë se evidencat e përftuara të auditimit janë të majtueshme dhe të përshtatshme për të na ofruar një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në pajtueshmëri me dispozitat e raportimit financier të organizatës dhe ligjeve relevante në Kosovë dhe për kontolle të tillë të cilat menaxhmenti përcakton se janë të domosdoshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, qoftë për shkak të mashtimit ose gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së organizatës të vijojë sipas hipotezës së vijimësisë, duke shpalosur, nëse është e zbatueshme, çështjet lidhur me hipotezën e vijimësisë dhe duke përdorur bazën e kontabilitetit bazuar në vijimësi përvëç nëse menaxhmenti ka për qëllim të likuidojë ose të ndërpresë aktivitetet e organizatës, ose nuk ka ndonjë alternativë tjetër përvëç të veprojë në këtë mënyrë.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financier të organizatës.

Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të përftojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtimit ose gabimit dhe të japid një raport të auditorit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garancion se auditimi i kryer sipas SNA gjithmonë do të zbulojë anomali materiale kur ekzistojnë ato. Anomalitë mund të paraqiten nga mashtimi ose gabimi dhe konsiderohen që janë materiale nëse, individualisht ose të grumbulluara, ato mund të ndikojnë në mënyrë të arsyeshme në vendimin që marrin përdoruesit bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në pajtueshmëri me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional përgjatë tërë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtimit ose gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit si përgjigje ndaj këtyre rreziqueve dhe përflojmë evidenca të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të na ofruar bazë për opinionin tonë. Rreziku i mosbulimit të anomalive materiale për shkak të mashtimit është më i lartë se ai i shkaktuar nga gabimet,

pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshjet e fshehta, falsifikimin, lënjen anash me qëllim, keqinterpretimin ose anashkalimin e kontolleve.

- Përftojmë njohuri mbi kontrolllet e brendshme që janë relevante për auditimin në mënyrë që të projektojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për ato rrethana, por jo me qëllim të jipim një opinion mbi efektivitetin e kontolleve të brendshme të organizatës.
- Vlerësojmë përshtatshmérinë e politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmérinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse nga menaxhmenti.
- Përfundojmë mbi përshtatshmérinë e përdorimit të hipotezës së vijimësisë nga ana e menaxhmentit dhe bazuar nga evidenca e përfthuar e auditimi, nëse ekziston ndonjë pasiguri materiale lidhur me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshim domethënës mbi aftësinë e organizatës për të vijuar ekzistencën. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet të tërheqim vëmendjen në reportin tonë të auditorit në shpalosjen përkatëse të pasqyrave financiare ose, nëse një shpalosje e tillë është e pamjaftueshme, ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të përfthuara deri në datën e reportit të auditorit. Mirëpo, ngjarjet dhe kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që organizata të mos vijojë aktivitetet e saj.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, në mes tjerash edhe lidhur me fushëveprimin e planifikuar, kohën e auditimit dhe gjetjet domethënëse të auditimit, përfshirë çfardo mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm të identikuara gjatë auditimit tonë.

Lulzim Zeka
Auditor ligjor

Baker Tilly Kosovo
Prishtina, Kosovo

26 mars 2019



FONDACIONI KOSOVAR PËR SHOQËRI CIVILE

PAQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

Me 31 dhjetor 2018
(Të gjitha shumat në Euro)

Me 31 dhjetor	Shënime	2018	2017
		Euro	Euro
ASETET			
Asetet jo-qarkulluese			
Pajisjet dhe automjelet	3	41,327	39,321
Gjithsej Asetet jo-qarkulluse		41,327	39,321
Asetet qarkulluese			
Parapagime	4	411,307	411,307
Grantet e parapaguara	5	510,189	1,352,645
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	6	1,188,836	2,044,762
Gjithsej Asetet qarkulluese		2,110,332	3,808,714
GJITHSEJ ASETET		2,151,659	3,848,035
FONDI DHE DETYRIMET			
FONDI			
Bilanci i fondeve 01 janar 2018		450,626	268,892
Teprica / Deficiti I vitiit		2,007	181,734
Gjithsej fondi		452,633	450,626
DETYRIMET			
Llogari të pagueshme dhe detyrimet tjera afatshkurtë	7	92,494	2,550
Të hyrat e shtyra	8	1,606,532	3,394,859
Gjithsej Detyrimet		1,699,026	3,397,409
GJITHSEJ DETYRIMET DHE FONDI		2,151,659	3,848,035

Këto pasqyra financiare u aprovuan dhe u nënshkruan më datë 15 mars 2019, në emër të menaxhmentit nga:

Taulant Hoxha
Drejtëor Ekzekutiv

Edona Haliti,
Drejtoresh e Financave dhe
Administratës

FONDACIONI KOSOVAR PËR SHOQËRI CIVILE

PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE
për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2018
(Të gjitha shumat në Euro)

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor		2018	2017
	Shënimet		
Të hyrat			
Kontributet dhe grantet	9	3,472,288	2,485,290
Të hyrat tjera	10	50,476	51,121
Gjithsej të hyrat		3,522,764	2,536,411
Shpenzimet			
Shpenzimet e projekteve	11	(555,594)	(668,534)
Shpenzimet e projekteve - Grantet	11	(2,585,034)	(1,588,004)
Shpenzimet Administrative	11	(90,393)	(127,158)
Shpenzimet tjera	11	(291,744)	(152,715)
		(3,522,764)	(2,536,411)
Rregullimet për pasuritë fikse	3	(14,282)	(30,965)
Rregullimet për parapagimin e objektit të zyreve të reja		-	(163,898)
Shpenzimet e zhvlersimit	3	12,275	13,129
Gjithsej shpenzimet		(3,520,757)	(2,354,677)
Teprica (deficit) neto		2,007	181,734

Shënimet shoqëruese nga 1 deri në 13 të pasqyrave financaire janë pjesë integrale e tyre.